

DRAFT VLERESIMI NDIKIMI NE MJEDIS

TE SUBJEKTIT :

« Miell Tirana » SH.A



Aktiviteti: Fabrike Prodhimin e miellit

Vendndodhja: Ish –Ndermarrja Grumbullim dhe Perpunimit te miellit, Tirane,Albania

Tirane me, Prill 2016

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes.

Sebashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme, ne menyre te ngjashme, me te njejten shpejtesi, eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marr parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme

Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyrore.

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Vleresimi mjedisor ne nje kuptim te gjere percakton vleresimin e perberjes dhe te kushteve te mjedisit biofizik dhe te mjedisit njerzor ose jo-njerzor. Karakterizimi i gjendjes dhe i tendencave mjedisore (duke u nisur nga te dhenat retrospektive dhe eventualisht prespektive), kalkulimi ose vleresimi i presioneve antropike te bere ne mjedis, pasojat ose modelet e menaxhimit prej njeriut jane aspektet kryesore te vleresimit mjedisor.

Vleresimi mjedisor eshte gjithmone i tipit trashegimor, por ai mund te behet mbi nje vend ose nje burim natyror te veçante. Nje qasje natyraliste duhet te jete e kontekstualizuar, domethene, te jete e vendosur ne kontekstin e saj hapesor, kohor dhe te ekopeisazhit. Kur vleresimi duhet te vazhdoje ne kohe, flitet per nje “biombikqyrje” ose “biomonitorim”, qe pergjithesisht perfshin mbikqyrjen e biodiversitetit. Kjo eshte etapa e pare e nje studimi te impaktit, por ajo mund te ribehet pas realizimit te projektit per te verifikuar, nese masat mbrojtese ose ato kompensuese, kane patur rezultatet e duhura.

Ky raport vleresimi mjedisor perqendrohet ne nevojat mjedisore te Shqiperise, te para keto ne kuadrin e zhvillimeve te gjera rajonale. Ashtu si edhe shtetet fqinje te saj, Shqiperia eshte vendi i disa prej burimeve natyrore me te çmuara dhe te pasura te Europes. Keto burime, megjithate, kane vuajtur pasojat e dekadave kur aktiviteti industrial ne vend nuk kryhej sipas standardeve te duhura. Mbrojtja e mjedisit po hedh hapa perpara krahas zhvillimit ekonomik. Tani Shqiperia ka mundesine te ndaloje shkaterrimin e mjedisit te saj te çmuar dhe, ne te njejten kohe, te krijojte nje ekonomi te forte dhe begati per shtetasit e saj. Megjithate sfidat e veshtira sociale dhe ekonomike, Shqiperia ka nisur krijimin e nje kuadri per perballimin e problemeve mjedisore qe kane dale gjate dekadave te industrializimit dhe me pas. Kushtetuta e vendit parashikon qe Republika te ruaje "nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem". Burimet natyrore duhet te "shfrytezohen ne menyre racionale" sipas "parimit te zhvillimit te qendrueshem".

Per realizimin e ketyre qellimeve duhet :

- Bashkepunim me i ngushte nderqeveritar.
- Ngritja e njesive mjedisore ne ministrite kryesore dhe bashkite ne Republiken e Shqiperise.
- Te permiresohet sistemi i inspektimit te mjedisit.
- Te ngrihet nje sistemi informacioni mjedisor.
- Te fuqizohet sistemi i vleresimit te ndikimit ne mjedis.
- Te plotesimin kuadrit ligjor mjedisor.

PERSHKRIMI I IMPIANTIT DHE I TEKNOLOGJISE

➤ *Profili i propozuesit*

Shoqëria Miell Tirana sha është krijuar ne Vitin 1995 si rezultat i procesit te privatizimit te ish Ndërmarrjes shtetërore te Grumbullim dhe Përpunimit te Drithërave. Si aktivitet është përpunimi i grurit dhe prodhimi i miellit ushqimor nga gruri. Mielli ushqimor prodhohet ne 5 tipe sipas rezes se tij dhe konkretisht: miell tip 500, miell tip 900, miell tip 700, miell tip 450, e ne 10 ambalazhime te ndryshme nga ambalazhimi ne thasë plastik 50 Kg ne ambalazhimin ne thasë letre 25 Kg. Kemi edhe prodhim te miellit 1 Kg sipas rezeve si me sipër. Si nënprodukt del hime e cila përdoret për konsum ne blektori. Mielli i prodhuar ne fabrikën e Miell Tirana sha është i një cilësie shume te larte konform standardeve ndërkombëtare me mbi 12 % proteine dhe materialet ndihmese qe përdoren janë te gjitha me baze biologjike. Linja teknologjike qe është instaluar ne fabrike është Linja Zvicerane e markës BUHLER, qe është teknologjia me e mire ne Bote për prodhimin e miellit ushqimor. Shoqëria Miell Tirana sha ka Laboratorin e saj me aparaturat e fjalës se fundit te teknologjisë për analizat e grurit dhe te miellit dhe është i vetmi laborator ne Shqipëri i Akredituar nga Drejtoria Akreditimit pranë MEZHHTTS. Gjithashtu ne këtë shoqëri funksionon prej vitesh sistemi ISO 220000 dhe sistemi HACCAP i cilësisë. Slogani i prodhimit te shoqërisë është: "Cilësia e Larte, Garanci për shëndetin e Familjes Suaj". Kapaciteti përpunues linjës teknologjike është 240 ton ne dite.

PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Përshkrimi i procesit të punës dhe Aktiviteti i shoqërisë

Ne kete fabrike prodhohen disa tipe mielli ne varesi te kerkeses se konsumatorit.

<i>Tipi i miellit</i>	<i>% e kokrres se hequr</i>
- Tip 45 miell shume i bardhe pasticerie	30-35
- Tip 55 miell i bardhe i zakonshem	25-30
- Tip 65 miell per ushqim biologjik	20-25
- Tip 80	15-20

- Tip 110 10-15
- Tip 150 miell integral 2-10

Te gjitha proceset ne fabrike jane te kompjuterizuara dhe automatike.

Largimi i bulbes(qe eshte ndare gjate bluarjes) me ane te sitjes.

Largimi i krundeve(sitje olus ndryshim densiteti me ane te aspirimit ne ajer)

Marrja e miellit te albumenit nepermjet kalimit ne cilindra te sheshte. Me pas mielli peshohet ne repartin e peshimit dhe paketohet ne repartin e paketimit ne formate:1 kg,10 kg,25 kg,50 kg.Krundet dhe bulba qe dalin nga procesi teknologjik shiten ne kompani te ndryshme si ushqim blegtoral.

1. Teknologjia e Prodhimit të Miellit

Si përbërës kryesor i bukës, makaronave dhe shumë prodhimeve të tjera mielli ka një rëndësi jetike për prodhimet e pjekura dhe prodhimi i tij nga bluarja është ndër operimet e para dhe më të rëndësishme industriale. Kështu, proceset e bluarjes janë zhvilluar hap pas japi nga përpunimi shtëpiak dhe i fshatit, në përpunim industrial në shkallë të gjerë prodhimi. Objekti i parë për prodhimin e miellit është për ti bërë drithërat më të përshtatshëm për ushqim, duke rritur kështu vlerat teknologjike të tyre. Teknologjia e prodhimit të miellit konsiston, në radhë të parë, në bluarjen dhe ndarjen e drithit. Cilësia e miellit të prodhuar përgjatë procesit të bluarjes do të varet nga sekuenca e operimeve të kryera dhe shkalla e arritjes së ndarjes. Përcaktimi i cilësisë do të ndryshojë, gjithashtu, sipas qëllimit përfundimtar të përdorimit, qoftë për bukën me miell të bardhë, me miell të pasitur apo bukët artizanale. Procesi kryesor i teknologjisë së prodhimit të miellit është bluarja, i cili është një proces i vazhdueshëm në të cilin lënda e parë (drithi i papërpunuar) transformohet në një formë e cila përdoret për bukëbërje dhe industri të tjera, si dhe konsumatori shtëpiak. Ka një mënyrë të pranueshme nëpërmjet së cilës mielli prodhohet në mënyrë globale, e njohur si sistemi i reduktimit gradual. Ky është procesi i marrjes së grurit të papërpunuar dhe duke kaluar në një seri fazash thërrmimi e sitjeje, prodhon miellra të bardhë të cilësisë dhe prodhueshmërisë së dëshiruar. Sistemi i reduktimit gradual ka mundësuar prodhimin e miellrave me përmbajtje të ulët hiri dhe produktivitet të lartë. Miellrat e cilësisë së lartë prodhohen nëpërmjet ekstraktimit të nënprodukteve shumë të pastra gjatë po këtij procesi. Procesi i bluarjes mund të paraqitet nga një diagram e thjeshtë. Aty ndahen në tre sektorë kryesor brenda procesit. Këto sektorë janë:

- sektori i thyerjes,
- sistemi pastrimit
- sistemi i reduktimit.

2. Pastrimi paraprak i drithërave

Në përgjithësi drithi mbërrin në fabrikë pasi është bërë një pastrim paraprak megjithatë aftësia e konsiderueshme e linjave të parapastrimit të siloseve bën të mundur vetëm një ndarje në vija të trasha dhe të parregullta të trupave të huaj dhe pluhurave, me qëllim përmirësimin e konservimit. Parapastrimi eliminon letrat, kashtën, spangot, copa tekstile ose plastike, copëza dheu, njëkohësisht edhe një pjesë të rërës dhe të pluhurave që ndodhen në drithë, por nuk arrin ta bëjë drithin gati për bluarje pa kryer më përpara edhe një pastrim më të imët. Para bluarjes drithi i nënshtrohet disa operimeve paraelementare. Operimi i parë nga këto është pastrimi i grurit. Gruri pasi është sjellë në fabrikë, analizuar dhe magazinuar në një silos, duhet ndarë nga çfarëdo lloj ndotësi tjetër me qëllim që të përgatitet për bluarje, (kokrrat e rrudhosura, të papjekura, kokrra të prishura, farëra të tjera, rëra, kashta dhe gurët). Sitja e thjeshtë eliminon grimcat e imëta nga ato të trasha, aspirimi heq materialet më të lehta dhe sitja në plane të pjerrëta ndan materialet me dendësi më të madhe, si gurët.

3. Makinat për pastrimin e drithërave

Gjatë ruajtjes së drithit, silosi është i pajisur me një linjë të saktë para-pastruese, me grupe peshimi dhe impiante aspirimi, sisteme kontrolli automatike të temperaturës dhe me impiante të përshtatshme ventilimi. Nga silosi, gruri dërgohet në siloset ditore ose të përzierjes, nga të cilat merret sasia e parashikuar dhe dërgohet në seksionin e pastrimit nëpërmjet elevatorëve dhe spiraleve. Në procesin e pastrimit instalohen dy reparte pastrimi. Në pastruesin e parë vendosen: Peshorja, e cila kontrollon peshën e grurit para se të hyjë në proces.

Ndarësi, makineri pothuajse e njëjtë me atë të parapastrimit në silos por më e efektshme, shërben për të hequr, nëpërmjet sitës mesatare, pjesët e huaja më të mëdha dhe ato më të vogla të urthit të grurit.

4. Filtri i aspirimit, për evidentimin e kashtës dhe pluhurave

Aparati magnetik, përndarjen e trupave të hekurt. Pastruesit e farërave, për eliminimin e farërave të huaja, si grashina që i kanë shpëtuar procesit të ndarjes. Ndarësit e gurëve të vegjël, për ndarjen nëpërmjet peshës specifike të gurëve të mbetur në grurë, për shkak të masës së njëjtë me farërat e grurit. Larësi ose lagësi intensiv i grurit, për ti dhënë grurit lagështinë e përshtatshme për bluarje.

Depot e pushimit, ku gruri i butë mund të qëndrojë rreth 24 orë dhe ai gjysmë i forte 36 orë, derisa të ketë hyrë në mënyrë uniforme në endospermën e grurit. Pastruesi intensive, kryen funksionin gjatë dy fazave të pastrimit nëpërmjet fërkimeve të forta ku eliminohen kokrrizat boshe dhe mbetjet e dheut. Filtri i aspirimit, vihen në punë në pastrimin e parë dhe të dytë për të eliminuar mbetjet e pluhurave, pjesët e insekteve etj, të mbetura nga proceset e mëparshme të pastrimit. Peshorja, për kontrollin e peshës së grurit të pastruar dhe të thatë që futet për bluarje. Aparati magnetik, për eliminimin e çfarëdo mbetjeje të hekurt. Ndërtimi i një impianti pastrimi varet, përveç qëllimeve të prodhimit të blojës (grise për makarona, miellra specifike, miellra integrale, etj), edhe nga prejardhja e drithit dhe nga sasia e trupave të huaj të përzier në të. Impiantet e pastrimit duhet të kenë një strukturë të saktë, meqenëse përftimi i miellrave apo griseve varet direkt nga sasia dhe cilësia e pastrimit, si dhe nga kondicionimi i grurit. Diagrama e pastrimit, ndryshe nga ajo e blojës, është esencialisht lineare dhe përbëhet nga makineritë e mëposhtme:

- Pastrimi: Matësit e vëllimit ose Matësit e peshës
 - Peshorja automatik
 - Vibroseparatori
 - Taruesi i aspirimit
 - Aparati magnetic
 - Ndarësi i gurëve në të thatë
 - Bateria e pastruesit të farave ose separatori
 - Seleksionuesit spiral
 - Pastruesit intensive
 - Impianti i plotë i aspirimit
- Pushim : Lagësi intensive i grurit, depo e pushimit të parë
- Pushim: Matësit e vëllimit ose matësit e peshës. Lagësi automatik i grurit, depo e pushimit

- Pastrimi: Matësit e vëllimit ose Matësit e peshës
- Pastruesit intensivë

Makineritë që përdoren në procesin e pastrimit janë: Peshoret elektropneumatike, matëset e vëllimit, peshoret elektronike, peshoret elektronike tubular, donatorët peshues elektronik të cilët shërbejnë për matjen e peshës së drithit që hynë në përpunim. Vibroseparatorët, janë makineri që direct pas peshimit ushtrojnë aktivitetin e tyre, duke ndarë papastërtitë me anë të vibrimit. Aparatet magnetike janë makineri që pastrojnë drithin nga material të hekurta të formave të ndryshme, si gozhda, vida, dado, bulona, tela ose pjesë llamarine, në rrulat e bluarsave, në fletët e plansisterit dhe në përfunduesit vibrant, si dhe për të reduktuar rreziqet nga zjarri dhe shpërthimet në sallat e punës.

Këto material të hekurta vijnë në radhë të parë nga fshirja dhe punime të tjera që i kryen drithit para se ai të arrijë në silose, por edhe mund të shkëputen nga makinat e transportit, nga reparatet e parapastrimit të silosit ose të pastrimit të mullirit. Këto makineri tërheqin metalet me anë të forcave magnetike duke bërë të mundur largimin e tyre nga drithi. Aparatet e pastrimit të gurëzave, të cilat mundësojnë eliminimin e gurëve. Triori është një makineri tjetër e cila bën të mundur ndarjen kokrrave të huaja nga drithi.

5. Përgatitja e drithit për bluarje

Pastrimi i drithit është një proces që paraprinë bluarjen, dhe e përgatit atë për etapat e mëvonshme të përpunimit. Kondicionimi i drithit është një proces që kryhet pas pastrimit, dhe qëllimi kryesor i tij është që të bëjë drithin të përshtatshëm për bluarje. Duke qenë se drithërat e grumbulluara nuk kanë të njëjtat karakteristika dhe të njëjtën cilësi, pra nuk janë homogjene, procesi i kondicionimit ka për qëllim zvogëlimin e diferencave ndërmjet kokrrave të drithit të grumbulluar. Pra kondicionimi mban homogjenitetin në drithë. Kondicionimi ka për qëllim përgatitjen e drithit për bluarje dhe ka këto efekte në drithë:

Lagështi uniforme në mes varieteteve të ndryshme të drithit. Perikarpin në kushte më të mira fizike për tu shkurtuar lehtë nga pastruesit e farërave intensivë gjatë pastrimit të dytë. Sipërfaqet e jashtme të endospermës pak më të lagështa për të nxjerrë himet e gjëra që janë më të thjeshta për tu përpunuar. Pengesat ngjithëse të endospermës dhe kores shumë të rralluar për të thjeshtuar ndarjen e krundës Endospermë të zbutur për konsum më të vogël të energjisë elektrike gjatë blojës.

Kondicionimi nuk është gjë tjetër veçse lagia me sprucim e grurit dhe lënia e tij për një kohë të caktuar në silose. Kjo kohë është e ndryshme për lloje të ndryshme gruri dhe varion nga 8-18 orë. Në përgjithësi grurërat e fortë lihen në këto silose për një kohë më të gjatë se grurërat e butë.

Kondicionimi i grurit si proces teknologjik është shumë i rëndësishëm pasi ndikon në mënyrë direkte në cilësinë e miellit, ai ndikon në vetitë mekanike, strukturën dhe cilësinë e drithit. Kur mbaron koha e kondicionimit bëhet matja e lagështisë së grurit nëse janë arritur parametrat e duhur. Gruri në siloset e kondicionimit nuk duhet të qëndrojë më shumë se çduhet, sepse më pas lindin problemet me aktivizimin e enzimave që kanë efekte negative në cilësinë e miellit. Pas kondicionimit gruri është gati për të kaluar në procesin e blajës.

6. Bluarja e drithërave

Bluarja është një proces shumë i rëndësishëm në përfitimin e miellit. Trupat e fortë i nënshtrohen bluarjes për marrjen e një materiali të shkrifët të përbërë nga pjesëza të një trashësie plotësisht të përcaktuar. Ky material paraqet në vetvete produktin përfundimtar, që i nënshtrohet përpunimit të mëtejshëm. Një metodë e tillë, e prishjes së trupave të fortë mund të quhet copëtim i thjeshtë. Ka raste të tjera ku trupat e fortë, jo të njëllojtë në përbërjen e tyre, i nënshtrohen copëtimit me anë të zgjedhjes me qëllim që të nxirren pjesëza të një lënde (substance) që hyn në përbërjen e trupit të dhënë. Në copëtimin me anë të zgjedhjes, që është i shumëllojshëm, procesin e ndërtojmë sipas radhës. Në këtë rast duke shfrytëzuar dallimet e vetive strukturo-mekanike të pjesëve përbërëse të trupit, në çdo stad të copëtimit, procesin e zhvillojmë të tillë që të marrim pjesëza të dallueshme nga njëra –tjetra, sipas këtyre apo atyre vetive, gjë që më tej lehtëson ndarjen e përzierjes së shkrifët sipas metodave të seleksionimit në një seri fraksionesh, secila prej të cilave përbëhen nga pjesëza të një përbërjeje të njëjtë. Në fabrikat e përpunimit të drithit, në varësi nga asortimenti i produktit të gatshëm të përpunuar, zbatohet ose bluarjen e thjeshtë ose bluarje e vështirë. Për përpunimin e grurit përdoret “bluarja e ndërlikuar”; copëtimi i grurit dhe i thekrës për miell sipas cilësisë bëhet duke shfrytëzuar vetitë dalluese strukturo-mekanike të endospermës dhe membranës. Gjatë copëtimit endosperma më e dobët ndahet në pjesë, kurse membranat plastike copëtohen në një masë më të vogël, gjë që lehtëson veçimin e tyre nga endosperma. Që të mos lejohet copëtimi i tepruar i membranave, në themel të ndërtimit të bluarjes është vendosur metoda e copëtimit të drithit dhe pjesëve të tij me anë të zgjedhjes. Kjo metodë e çon në minimum tharimin e membranave dhe nxjerr nga drithi një sasi maksimale të

endospermës.Përqindja e nxjerrjes së miellit nga drithi, si dhe cilësia e miellit, në një masë të konsiderueshme varen nga përsosmëria e procesit të nxjerrjes së miellit.

Zgjedhja jo e drejtë e regjimit të copëtimit dhe karakteristikat e punës së organeve të makinave çojnë në përkeqësimin e cilësisë së miellit dhe si pasojë edhe të bukës.Ngrohja e lartë gjatë copëtimit e ul cilësinë e tyre.Nga copëtimi i tepruar ulet rendimenti i makinerive , rritet shpenzimi i energjisë gjatë copëtimit dhe rrjedhimisht rritet kostoja e produktit.Prandaj, për zgjedhjen e mënyrave të copëtimit duhet llogaritur një kompleks kërkesash të rëndësishme. Copëtimi dhe bluarja në industrinë e prodhimit të miellit është një proces me konsum të lartë energjetik.Analiza e punës së fabrikave të ndryshme ka treguar se fuqia që kërkon bluarja përbën 50-80% të gjithë fuqisë që duhet për drejtimin e proceseve teknologjike.

Në këtë mënyrë, nga ndërtimi i drejtë i proceseve të bluarjes varet: shfrytëzimi racional i lëndës së parë, cilësia e produkteve që merren, rendimenti i makinave të bluarjes,madhësia specifike e shpenzimeve të energjisë, si dhe kostoja e prodhimit.Në varësi nga detyrat kryesore të procesit të bluarjes dhe metodave të realizimit të tij përdoren disa makina (sipas parimit të presionit të organeve të tyre në produktin për bluarje), ose një seri makinash. Për bluarjen e imët të thjeshtë duhet të vërehen kushtet e mëposhtme:Bluarja e produktit deri në një shkallë të caktuar të trashësisë. Trashësia e miellit luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e vetive të tij bukëpjekëse. Është konstatuar se sa më të mëdha të jenë pjesëzat e miellit, aq më ngadalë ndodh fryrja në procesin e përgatitjes së brumit. Me zvogëlimin e përmasave të pjesëzave dhe me rritjen e sipërfaqes specifike të tyre rritet aftësia e miellit për të thithur ujin.Thërrmimi i njëjlojshëm i produkteve për ushqim për kafshët bën të mundur përvetësimin maksimal të lëndëve ushqyese që ai përmban; Mungesa në produktet për bluarje e përzierjeve metalike, minerale etj,që formohen si rezultat i konsumimit të sipërfaqeve punuese.Ngrohja minimale e produkteve në procesin e thërrmimit për të shmangur keqësimin e cilësisë së tyre.Për bluarjen e drithit për miell, të cilësisë së lartë, duhen patur parasysh këto kërkesa:Bluarja maksimale e pjesës më të vlefshme të drithit – endospermës;Marrjen e miellit me përmbajtje minimale të pjesëzave të membranave dhe embrionit.Sa më pak të përmbajë mielli pjesëza membranash, aq më e shndritshme dhe me volum të madh merret buka. Procesi i bluarjes së grurit dhe thekrës përbëhet nga këto etapa:

Formimi i kokrrizave nga copëtimi, pasurimi i tyre nëpërmjet grismakinave,bluarjes së griseve të pastruara, dhe përpunimi i produkteve përfundimtare.

7. Sitja (thelbi i procesit të sitjes)

Sitja është një proces i cili kryhet pas atij të bluarjes, dhe ka për qëllim largimin e krundeve pra pjesës së jashtme të kokrrave të drithit. Sitja kryhet nëpërmjet plansisterave të cilat janë të pajisura me sita të cilat në fillim janë me vrima më të mëdha dhe më pas vrimat bëhen me të vogla duke bërë kështu një fraksionim të drithit të bluar, dhe produkti që del nga plansisteri përbën miellin.

Funksionimi i plansisterave është i tillë:

Futja e produktit kryhet nëpërmjet kasave ose hinkave të posaçme të vendosura në një urë komandimi metalike të varur në tavan të cilat janë të lidhura me gypin rrethor të hyrjes së kanalit nëpërmjet manikotave prej cope sintetike. Menjëherë, poshtë gypit të hyrjes, ndodhet një disk i vrimëzuar distributor që ka për detyrë të shpërndajë produktin mbi gjithë sipërfaqen e sitës së parë. Produkti i imët, që ka përshkuar thurjet e sitës së parë, bie në fund të llamarinës grumbulluese, nga ku shtyhet, nëpërmjet nxjerrësve të posaçëm drejt daljes, ose në sipërfaqen e kanalit të veçantë vertikal, të lidhur me një gyp shkarkimi të vendosur në fund. Ndërsa, thërrmimet e mëdha të mbetura që nuk kanë kaluar ndërmjet thurjeve të telajove, dalin nga një dalje ballore e sitës për të rënë pastaj mbi sitën tjetër dhe kështu me radhë, deri në fund të seleksionimit, hyn në kanalën e tij anësor të shkarkimit. Nganjëherë kanali ndahet horizontalisht në dy grupe për të sitë dy produkte të ndryshme.

8. Përcaktimi i përmasave të grimcave dhe të sites

Sitat janë organet kryesore të punës së makinave sitës që përfaqësojnë një sipërfaqe pune në të shumtën e rasteve të sheshtë që ka vrima të përmasave të ndryshme dhe të formave të ndryshme.

Sitat karakterizohen nga këto madhësi:

Nga masa e punës p.sh të sitës me vrima drejtkëndëshe kuptohet intervali në minimal midis anëve të kundërta të vrimave.

Për vrimën e rrumbullakët si masë pune shërben diametrik, kurse për vrimat trekëndëshe, ana më e vogël e trekëndëshit. Shumë të përhapura janë sitat me rrjetë pëlhure, me rrjet teli, mëndafshi dhe fibre me vrima katrore. Për përcaktimin e përmasave të sitës përdoret lupa zmadhuese (1 cm), e cila lehtëson llogaritjen e sasisë së fijeve në njësinë e gjatësisë së sitës. Lupa përbëhet nga tri pllaka që bashkohen me tyre me sfera. Në pllakën e fundit ka vrimë katrore, anët e së cilës janë

kalibruar dhe janë të barabarta me 1 cm. Në pllakën e sipërme është vendosur një lente-okular. Pllaka e mesme bashkon dy të tjera në mënyrë të tillë që distance midis tyre është e barabartë me distancën që fokusohet nga lentja.

Sitat për ndarjen sipas trashësisë:

Seleksionimi i drithërave sipas trashësisë realizohet në sitat me vrima të zgjatura. Numër i sitës me vrima të zgjatura shërben gjerësia D për efektshmërinë e kalimit të pjesëve, gjatësinë e vrimës e bëjnë më të madhe se gjatësia e pjesëve të drithit. Sita për ndarjen sipas sipërfaqes dhe formës me prerje të tërthortë: Në sitat me vrima trekëndëshe ndajnë farëra që kanë në prerjen tërthore formën trekëndëshe me anë më të vogla se anët e vrimës. Për realizimin e një ndarjeje efektive të përzierjeve të drithërave, duhet para së gjithash materialin fillestar ta seleksionojmë në fraksione sipas gjerësisë me ndihmën e sitave me vrima të rrumbullakëta, më pas e kalojmë në sita me vrima trekëndëshe.

9. Llojet e sitave

Për të ilustruar më mirë plansisterin është e nevojshme të ndalohejmë në tipat e ndryshme të sitave të përdorura nga këto makineri për të klasifikuar pjesët e miellit në mulli. Quhen “telajo” thurjet sitës që aplikohen në sitat e plansisterit, në grismakina, në imtësuesit vibrant etj. Të cilët duhet të klasifikohen sipas përmasës së kornizës së produktit që vjen nga cilindrat. Këto copa sitës që mund të fabrikohen me fije metalike ose prej mëndafshi ose prej material sintetike kanë thurje në formë kuadrate nëpërmjet të cilave kalon fraksioni më i imët i materialit që do të seleksionohet, i quajtur “produkt”; kurse fraksioni më i trashë që mbahet nga këto thurje quhet “mbetje”.

Për fabrikimin e telajove përdoren telajot normale të industrisë tekstile, ku mekanizmat thurës ndërpusin fjetet zinxhir (të vendosura vertikalisht) me ato “tymën” (të vendosura horizontalisht) duke krijuar një kuadrat me një “dritë thurjeje” të posaçme neto. Telajot karakterizohen nga dimensionet e mëposhtme, të shprehura në “mikron” tre të parat dhe në përqindje e katërta:

Dritë neto e thurjes “I” ;

Diametri I fijes “ I + d “ ;

Largësia mes të mesmeve të fijes ““ I + d “ ;

Raporti mes sipërfaqes së hapur dhe asaj totale “r”. Sitat më të përdorshme janë ato metalike (në hapat e para të sitjes) dhe ato sintetike në fund të këtij procesi.

10. Sitat metalike

Më parë shumë të përhapura kanë qenë sitat me thuarje metalike zingate, sot kanë dalë jashtë përdorimit pasi janë zëvendësuar me telajo më rezistente prej çeliku inoks, të cilat falë fijeve të holla në diametër ofrojnë 25% më tepër sipërfaqe të hapur. Jetëgjatësia e fijeve prej çeliku inoks është të paktën tre herë më e madhe se ajo e atyre metalike zingate, kështu që kostoja e lartë e tyre kompensohet vetëm me faktin që ato durojnë më gjatë dhe kursejnë kohën e ndalimit të impiantit për zëvendësimin e telajove të dëmtuara.

Falë tekstileve prej fibre sintetike, si najloni apo poliestra, është bërë e mundur rritja e rendimentit sitës të plansiserëve moderne deri në 30-40% në krahasim me telajot e vjetra prej mëndafshi që janë edhe më delikate. Telajot sintetike përdoren për të situar miellin e himet dhe fabrikohen që nga viti 1950, ku kimikatet e polimerë pësuan zhvillim të jashtëzakonshëm, duke krijuar fibra të reja sintetike si najloni dhe poliestra monofile, shumë më rezistente se fijet multifile, gjë që çon në përdorimin e fijeve më të holla në favor të një sipërfaqe të lire më të madhe. Janë sita me thurje absolutisht të njëjta dhe konstante. Fijet e thurjes pasi i nënshtrohen trajtimeve të veçanta kimike dhe termike –që eliminojnë ngarkesën elektrostatische, reduktojnë rrudhat dhe përforcojnë qëndrueshmërinë, kalohen në linjat që mundësojnë prodhimin e telajove shumë rezistente ndaj çarjes, konsumimit, gërvishtjes dhe oksidimit.

Falë edhe elasticitetit dhe mos ndjeshmërisë ndaj vibrimeve të tyre, telajot sintetike mund të kenë një jetëgjatësi tre ose katër herë më të madhe se ato prej mëndafshi, përveç stabilitetit dimensional dhe rezistencës mekanike të mrekullueshme. Gjithashtu, korniza e copës ka sipërfaqemjaftueshmërisht të ashpër, në mënyrë që të lejojë produktin të kalojë ndërmjet hapësirave të thurjes në vend që të rrëshqas mbi guarnicion.

11. Llojet e miellit

Miellrat emërtohen sipas llojit të drithit nga i cili janë prodhuar. Kështu, kemi miell gruri, misri, thekre, elbi, tërshëre, etj. Miellrat e prodhuar nga i njëjti drithë, dallohen nga njëri tjetri nga rrezja e tyre. Rrezja e miellit tregon sasinë e miellit në kilogram, që prodhohet nga bloja e 100 kg drithë. Kështu, për shembull, mielli i grurit me rreze 0.85 (85%) tregon se nga bloja e 100kg janë marrë 85 kg miell. I njëjti arsyetim vlen edhe për drithërat e tjerë.

Tabela 1.1. Treguesit kryesorë të standardeve të miellrave të grurit

Nr	Treguesit	Llojet e miellrave				
		096	090	085	075	070
1	Lageshtia (%)	14	14	14	14	14
2	Hiri i pergjithshem (%)	2	1.6	1.4	0.8	0.7
3	Gluten i njome (%) Jo me pak	20	2.3	2.4	2.8	2.8
4	Numri i aciditetit(%) deri ne :	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5
5	Imetesia e blojes (%) a)mbetje mbi siten 4 b)mbetje mbi siten 5	6 15	5 10	4 8	- 2	- 2
6	Ngjyra	E bardhe me nuance te verdhe ose te hirte	E bardhe me nuance te verdhe ose te hirte	E bardhe me nuance te verdhe ose te hirte	E bardhe me nuance te verdhe ose te hirte	E bardhe me nuance te verdhe ose te hirte
7	Era dhe shija	Karakteristikat e miellit,pa ere e shije myk				
8	Kercitja ne dhembe Gjate pertypjes	Nuk lejohet				

- **Përdorimi i ajrit gjatë pastrimit dhe bluarjes**

Përdorimi i ajrit gjatë pastrimit

Në fabrikat e drithit ajri ka shumë rëndësi dhe përdoret shumë që nga pastrimibluarja e deri në ruajtje (me anë të ventilimit të masës së drithit).Pneumo- separatorët janë pajisje të cilat përdoren për pastrimin e drithit nga pjesët e lehta. Rryma e drithit hyn në kanal duke u kontaktuar gjatë rrugës së vet me rrymën e ajrit. Këta pneumo-separatorë mund të çojnë tek separatorët e thjesht me një veprim, ku përzierja e drithit si dhe pjesa e ndarë që hyn në përbërjen e kësaj përzierje,vetëm një herë i nënshtrohet presionit të rrymës së ajrit. Si rezultat i ndarjes merren dy fraksione, që dallohen nga vetitë aerodinamike të pjesëve.

Pneumo-separatorët e fabrikave të miellit, me transport të brendshëm pneumatik të drithit, punojnë sipas kësaj skeme: përzierja e drithit bashkë me ajrin drejtohet në dhomën precipituese në ciklone ku bëhet precipitimi i drithit që ndahet nga pjesët e lehta nga ajri. Në separator mund rregullohet regjimi i ajrit dhe si pasojë edhe efekti i pastrimit me anë të ndryshimit të diametrit të tubave transmetues. Për këtë përdoret mbyllësi lëvizës që është i mbërthyer në dy mekanizma rrotullues. Pra pneumo-separatorët përdorin rrymat e ajrit për të larguar nga drithi pjesëzat e lehta, pluhurat etj.

- **Përdorimi i ajrit gjatë bluarjes.**

Rrulat bluarës, duke punuar me ngarkesë të madhe dhe shpejtësi të madhe periferike, nxehen dukshëm, duke konvertuar fërkimin me nxehtësi; për rrjedhojë, si gruri, që hyn në thyerjen e parë me 16.517 % lagështirë, ashtu dhe produktet në proces, që gjithashtu kanë lagështi të konsiderueshme, shfaqin dukuritë e avullimit që tentojnë të shkaktojnë kondensime në anët e brendshme, shfaqin dukuritë e avullimit që tentojnë të shkaktojnë kondensime në anët e brendshme të strukturës së cilindrit të cilat kanë temperatura më të ulëta. Ky problem mënjanohet me aspirimin e mirë të makinerisë duke evituar kondensimet, kontribuar në mbajtjen pastër të sallës së cilindrave, dhe së fundi, çon produktin më të freskët drejt plansisterit, duke përmirësuar eficientësitë dhe reduktuar rrezikun e kondensimeve të mëvonshme. Për aspirimin e cilindrave pa konsumimin e mëtejshëm të energjisë elektrike, shfrytëzohet ajri i linjave pneumatike që tërheqin produktin e bluar për ta transportuar në plansister. Gjithashtu, me anë të një gypi që lidh dhomën e bluarjes me hinkën ushqyese, cilindri modern mban të aspiruar edhe mbulesën transparente. Kështu evitohet formimi i myqeve, baktereve, dhe kërpudhave në të, ku nxehtësia dhe lagështia ndihmojnë në zhvillimin e tyre. Në vendet tropikale, veçanërisht ato bregdetare ku lagështia relative dhe temperaturat janë të larta, fenomenet e kondensimit në cilindrata, si dhe plansisterët, janë më të shpeshta, prandaj aspirohet rezervuari cilindrit në pjesën e sipërme, me rreth $3 \text{ m}^3/\text{min}$ ajër për kalim.

- **Mjedisi rrethues**

Eshte punuar nga shoqeria "Miell Tirana" sh.a per mirembajtjen e objektit dhe eshte mbjelle nje sasi e konsiderueshme pemesh dhe bimesh te ndryshme per te krijuar nje mjedis sa me rekreativ ne territorin e objektit dhe perreth tij.

- **Magazinimi**

Mielli ne fabrike ruhet ne thase. Vendi ku ruhet eshte i thate, i paster, i ajrosur dhe i ndricuar mire. Thaset me miell vendosen mbi paleta. Ruajtjes se miellit i kushtohet nje rendesi e vecante pasi ne varesi nga kushtet e ruajtjes mund te ndodhin ndryshime te theksuara ne cilesine e miellit per buke si deh produkte te tjera te brumit.

- *Furnizimi me uje dhe me Energji Elektrike*

Per furnizimin me uje te pijshem eshte bere lidhja me rrjetin kryesor te zones. Furnizimi me energji elektrike gjithashtu sigurohet nga rrjeti ekzistues qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike.

PERSHKRIMI I RAJONIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETI

o Gjeologjia e rajonit

Ne kete rajon kemi te bejme me tokat e hirta e te kafta , keto toka jane formuar mbi shkembinj argjilor te neogjenit. Kane profile te diferencuara me ngjyre te hirte te kuqerremte, perberje mekanike subargjilore te mesme ne te rende. Perberja kimike e tyre tregon se jane mestarisht te pasura me humus. Persa i perket elementeve ushqyes te asimilueshme nga bimet keto toka paraqiten te varfera me azot dhe fosfor dhe te pasura ne patos. Kuota ku eshte ngritur ky aktivitet eshte me nje ngritje te vogel nga toke bujqesore e cila lejon qe te kemi vetrrjedhje te ujervae te bardha dhe te reshjeve. Nga ana gjeologjike ne bazamentin ne bazamentin ku eshte ndertuar ky aktivitet ka te bej me formacionin kuaternar Q₄AL. Formacioni argjilor nuk lejon qe ujerat siperfaqesore te reshjeve si dhe uejrat e ndotura te futen ne thellesi, por ato per shkak te kuotes se larte dhe kanaleve kullues drejtohen drejt kanalit kryesor ku para se te shkojne ne kuoten me te ulet ka nje grope dekantimi.

o Klima

Fieri ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, dhe dallohet për tipare më të shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe dimër i butë dhe me rreshje të mëdha. Ngricat dhe dëbora janë dukuri tepër të rralla. I nxehti fillon që prej mesit të pranverës dhe vazhdon deri në fund te tetorit. Klima e Fierit është e ngrohtë sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej erërave të ftohta. Fieri dallohet për numerin e lartë të ditëve me diell, mesatarisht 2800 ore në vit. Rreshjet kanë rregjim kohor shumë të çrregullt ato janë përqendruar kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000 mm/vit. Vera në Fier është e thatë dhe shpesh nuk bie shi për javë të tëra. Muajt më të lagesht janë nëntori dhe janari, kurse muajt më të thatë korriku dhe gushti.

Erërat fryjnë në drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje të mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Afërsia me detin bën qe klima te jetë e butë dhe vetëm ne raste tepër te rralla temperaturat të bien nën zero. Temperatura mesatare vjetore lekundet nga 150C-160C. Klima e Fierit lejon zhvillimin e një bujqësie shumë degëshe. Gjithashtu tokat bujqësore mund të shfrytëzohen 2-3 herë ne vit.Zona ku do zhvillohet aktiviteti ka klime mesdhetare fushore.

Temperatura mesatare me e larte eshte ne muajin korrik, gusht 23 °C, dhe me e uleta ne muajin Janar 7.2 °C. Ndryshimi i lageshtise relative te ajrit gjate vitit eshte i lidhur ngushte me ecurine e temperatures se ajrit. Vlerat me te larta te lageshtise jane ne periudhen e ftohte te vitit ndersa me te uleta ne periudhen e ngrohete te tij. Per arsye se jemi prane zones fushore dhe ne afersi te detit mbizoterojne erera nga kuadrati i perendimit dhe veri perendimit. Ne dimer mbizoterojne erera te lindjes dhe te jugut.

○ **Trashegimia arkitektonike**

Aktiviteti qe kryhet nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitekitektonike, objekte te trasheguara dhe te ndertuara nga njeriu me rendesi historike, sepse ne kete zone ato nuk ekzistojne. Eshte per t'u theksuar se ne kete zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonamente.

○ **Flora dhe fauna**

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë zona dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos ne pjeset bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshëm zvarranikesh e gjarprinjs. Ndërsa ne ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Zona bën pjese ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati I makies, ku rriten shkurret me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Ne këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure te lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, qe ne disa raste formojne pyje te vegjel.

NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS

Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve

Aktiviteti qe do zhvillohet eshte ai i bluarjes se drithit . Ky aktivitet duke qene se eshte nje aktivitet qe zhvillohet gjeresisht nuk perben rrezik per shendetin e punonjesve si dhe te popullsise perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata. Ne zhvillimin e aktivitetit nuk jane parashikuar ndryshime ne popullsine e zones, te zhvendosjes se saj, per shkak te tij. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative ne shendetin fizike dhe mendor te popullsise.

Nivelet dhe ndikimet e zhurmave

Gjate procesit te bluarjes vihet ne pune mulliri bluares, zhurma e te cilit eshte brenda normave te lejuara. Aktiviteti nuk gjeneron zhurma te tjera gjate zhvillimit te tij, te vetmet zhurma jane ato qe vijne si rezultat i automjeteve te cilat transportojne lenden e pare drithin si dhe produktin miellin , theksojme qe keto zhurma jane brenda niveleve dhe me kohezgjatje jo te madhe.

Ndikimet ne rruge lokale dhe transport

Zhvillimi i aktivitetit nuk sjell ndryshime ne rruge lokale dhe transport,apo te rris trafikun si rezultat i transportimit te lendes se pare dhe produktit.

Ndikimet ne toke , uje , ajer

Zhvillimi i aktivitetit nuk sjell pasoja negative ne mjedis. Nuk kemi shkarkime ne uje dhe ajer, pasi aktiviteti qe zhvillohet nuk gjeneron gaze apo ujera teknologjike qe te permbajne elemente kontaminues. Persa i perket mbetjeve qe dalin nga procesi i bluarjes ato grumbullohen dhe hidhen ne vendet e caktuara. Pluhuri i grurit qe krijohet nje pjese e tij thithet nga sistemi i ventilim-aspirimit dhe pjese me e madhe zbret nepermjet batitorit ne nje thes prites duke mos u perzier me miellin. Punetoret jane te pajisur me maska mbrojtese ndaj pluhurit qe krijohet.

Ndikimet ne ekonomi

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky aktivitet duke qene aktivitet prodhimi sjell ndikime pozitive jo vetem per zonen por edhe per rajonet e tjera , duke prodhuar miellin i cili eshte baza per prodhimin e bukes, si dhe te produkteve te tjera qe konsumohen gjeresisht nga popullata.

Ndikime mbi trashëgimë kulturore

Zona ku do zbatohet aktiviteti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore, pra nuk kemi ndryshime apo demtime të saj duke qenë se nuk ekziston në këtë territor.

Ndikimet në klimë

Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Nuk do të ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Pra kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimaterike të kësaj zone.

MASAT QË DUHEN MARRE PËR ELEMËNIMIN / MINIMIZIMIN E NDOTJEVE

Masat zbutëse të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë zhvillimit të aktivitetit, por siç është theksuar edhe më sipër ky aktivitet nuk sjell pasoja negative në mjedisin përreth ai ka ndikim pozitiv pasi prodhon miellin, produktet e të cilave kanë një konsumim të gjërë nga njerezit.

Masat për shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë

Siç është theksuar edhe më sipër aktiviteti nuk sjell shkarkime në ajër apo ujë që të shkaktojnë ndotje të tyre. Mbetjet që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm hidhen në konteneret përkatëse të caktuara nga pushteti lokal. Ujërat që përdoren për aktivitetin ditor, personal shkojnë drejt kanalizimeve përkatëse për të bashkuar kolektorin kryesor të zonës. Përsa i përket mbetjeve që dalin nga procesi i bluarjes ato grumbullohen dhe hidhen në vendet e caktuara. Pluhuri i grurit që krijohet në pjesë të tij thithet nga sistemi i ventilimit-aspirimit dhe pjesa më e madhe zbret nëpërmjet batitorit në një thes prites duke mos u përzier me miellin. Punetoret janë të pajisura me maska mbrojtëse ndaj pluhurit që krijohet.

Masat per ruajtjen e higjienes

Nëse pajisjet e përdorura gjatë bluarjes së drithit nuk do të jenë të pastra, atëherë edhe mielli nuk do të jete i paster dhe në kushte për tu përdorur dhe konsumuar nga njerezit. Prandaj tregohet një kujdes i veçantë nga personeli për pastrim dhe mbajtjen e pajisjeve, si dhe ruajtjen e drithit dhe të miellit në kushte të përshtatshme pa lagështi e me ndricim të mirë.

Masat kunder zjarrit

Në ambientet e fabrikës janë marrë masat kundër zjarrit duke vendosur hidrant kundër zjarrit në pjesë të dukshme të saj.

Masat kunder zhurmave

Aktiviteti nuk gjeneron zhurmë që mund të sjellin shqetësim për banorët përreth.

Vlerësimi i efektivitetit të pritshëm të masave zbutëse.

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuara do të varet nga respektimi i të gjitha masave që duhen marrë.

Mbrojtja nga zjarri

Për një siguri maksimale në ambientet e fabrikës nga drejtuesit e saj, janë marrë të gjitha masat për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes nga zjarri.

Brenda ambientit të punës janë vendosur në vende të dukshme pajisje të mbrojtjes nga zjarri, numrat e telefonit të zjarrfikësve, urgjencës dhe policisë, si dhe janë marrë masa për të kryer instruktimin e punonjësve në mënyrë periodike.

Punëdhënësi ka detyrë:

- Të kualifikojë punonjësit, për teknologjinë në përdorim, proceset e punës dhe kërkesat teknike që duhet të zbatohen.
- Të pranojë në punë persona të aftë nga ana shëndetësore dhe mendore që e vërteton me raport mjekësor.
- Të instruktojë punonjësit për proceset e punës që do të kryejnë.
- Të njohë me rregulloret e sigurimit teknik në fuqi.
- Të njohë me rregulloren e mbrojtjes nga zjarri.

- Tju beje te ditur shkaqet e aksidenteve dhe masat qe duhet te merren per ti menjanuar ato.
- Te kualifikoje punonjesit per te qene te afte te japin ndihmen e shpejte ne raste aksidentesh.
- Te siguroje mjetet mbrojtese individuale dhe kolektive per punonjesit.
- Te monitoroje nivelin e sigurise ne pune te fabrikes.

Punemarresi ka detyre:

- Te kualifikohet per procesin e punes qe do te kryeje.
 - Te zbatoje rregulloret e sigurimit teknik ne pune.
 - Te perdore mjete individuale mbrojtese ne pune.
 - Te mos lejoje qe punen e tij ta kryeje nje punonjes tjetër.
 - Kur konstaton avari, merr masa per ta eleminuar ate dhe njofton menjehere drejtuesin teknik.
 - Te jap ndihmen e shpejte shokut ne raste demtimi.
 - Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
 - Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjes ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt fillon punen .
 - Kur nuk ndihet mire me shendet ve ne dijeni pergjegjesin dhe largohet nga fronti punes.
-
-

